



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 65 Prot.

Tiranë, më 06.02.2020

MIRATOHET

DREJTOR

Mimoza ÇULIQI



RREGULLORE E BRENDSHME

PËR PËRZGJEDHJEN E BASHKËPUNTORËVE TË JASHTËM

TIRANË

## Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike, i ndryshuar”, Ligjin Nr.16/2018 datë 5.4.2018 “Për Diasporën”, Ligjin Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to” VKM-në Nr. 469, datë 26.7.2018, “Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, VKM Nr.120 datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen me veprimtarinë e këtij institucioni.

### Neni 1

#### Objekti

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët duhet të angazhohen në përmbushje të fushës së veprimtarisë së “Qendrës së Botimeve për Diasporën”, (më poshtë QBD) në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj.
2. Kjo rregullore përcakton kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, duke siguruar kritere dhe rregulla të njëjta për kandidatët, bashkëpunëtorë, si dhe duke garantuar pjesëmarrjen aktive të tyre në procesin e aktiviteteve të kësaj Qendre.

### Neni 2

#### Subjektet

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë **kandidatët, bashkëpunëtorë të jashtëm**, të cilët kërkojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të ndihmuar QBD-në në realizimin e detyrave kryesore të saj
2. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet nga komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të QBD-së sipas procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore.

### Neni 3

#### **Regjistrimi i kandidatëve - bashkëpunëtorëve të jashtëm si ekspertë të angazhuar në fushën e hartimit/rishikimit të programeve dhe materialeve ndihmëse për mësuesit**

1. Mbështetur në këtë rregullore, të drejtën për regjistrim si kandidatë, bashkëpunëtorë të jashtëm si **hartues/rishikues të programeve, teksteve dhe materialeve ndihmëse** e gëzojnë të gjithë personat që plotësojnë këto kritere:

### 1.1 Kërkesa të përgjithshme:

- a) Të kenë përvojë pune mbi 5 vjet si mësues në arsimin e mesëm parauniversitar ose arsimin e lartë;
- b) Të kenë përvojë pune mbi 5 vjet në ciklin/profilin përkatës;
- c) Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- d) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- e) Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- f) Të përdorin kompjuterin.

### 1.2 Kërkesa të veçanta për hartuesit/rishikuesit e kurrikulave, standardeve dhe programeve lëndore:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin/profilin përkatës;
- b) Të kenë përvojë mbi 5 vjet në mësimdhënie;
- c) Të kenë vlerësimin shumë mirë ose shkëlqyeshëm në provimin e kualifikimit (nëse e kanë dhënë një të tillë);
- d) Të njohin metodologjinë e hartimit të kurrikulave/programeve në arsimin parauniversitar;
- e) Të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillim të tyre profesional.

### 1.3 Kërkesa të veçanta për redaktues shkencorë të kurrikulave/programeve:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin profilin përkatës;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e dokumentacionit kurrikular;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin shkencor të dokumentacioneve kurrikulare.

### 1.4 Kërkesa të veçanta për redaktues letrarë të kurrikulave/programeve:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në profilin gjuhë - letërsi;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e dokumentacionit kurrikular;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin letrar të dokumentacioneve kurrikulare.

## 2. Mbështetur në këtë rregullore, të drejtën për regjistrim si kandidatë, bashkëpunëtorë të jashtëm si hartues të materialeve ndihmëse për mësuesin, e gëzojnë të gjithë personat që plotësojnë këto kritere:

### 2.1 Kërkesa të përgjithshme:

- a) Të kenë përvojë mbi 5 vjet si mësues në arsimin e mesëm parauniversitar ose arsimin e lartë;
- b) Të kenë përvojë pune mbi 5 vjet në ciklin/profilin përkatës;
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- d) Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- e) Të përdorin kompjuterin.

### 2.2 Kërkesa të veçanta për hartuesit e materialeve ndihmëse për mësuesit:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin/profilin përkatës;
- b) Të kenë përvojë në hartimin e materialeve ndihmëse të mësuesve;
- c) Të kenë përvojë mbi 5 vjet në mësimdhënie;
- d) Të kenë vlerësimin shumë mirë ose shkëlqyeshëm në provimin e kualifikimit (nëse e kanë dhënë një të tillë);
- e) Të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillimin e tyre profesional.

2.3 Kërkesa të veçanta për redaktues shkencorë të materialeve ndihmëse të mësuesve:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin/profilin përkatës;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e dokumentacionit kurrikular;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin shkencor të dokumentacioneve kurrikulare.

2.4 Kërkesa të veçanta për redaktues letrarë të kurrikulave/programeve:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në profilin gjuhë-letërsi;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e një materiali ndihmës të mësuesve;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin letrar të materialeve ndihmëse të mësuesve.

3. Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) CV;
- b) Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë;
- c) Vërtetim nga punëdhënësi mbi vjetërsinë në arsim dhe në profilin përkatës;
- d) Fotokopje e dokumentit origjinal, që vërteton kryejten e kualifikimeve, trajnimeve dhe specializimeve të ndryshme (nëse disponohen);
- e) Përmbledhje e shkurtër e materialeve të redaktuara (për kandidatët që do të realizojnë redaktimet).

#### Neni 4

**Regjistrimi i kandidatëve bashkëpunëtorëve të jashtëm si ekspertë të angazhuar në studime/analiza në fushat e përmbajtjes, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie.**

1. Mbështetur në këtë rregullore, të drejtën për regjistrim si kandidatë, bashkëpunëtorë të jashtëm si **ekspertë të angazhuar në studime dhe analiza** e gëzojnë të gjithë personat që plotësojnë këto kritere:

1.1 Kërkesa për ekspertë të angazhuar në studime dhe analiza:

- a) Të kenë eksperiencë në studime dhe analiza në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimin në tërësi;

- b) Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- d) Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- e) Të përdorin kompjuterin.

1.2 Kërkesa për redaktues letrarë të studimeve dhe analizave:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në profilin gjuhë - letërsi;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e studimeve dhe analizave;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin letrar

2. Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) CV;
- b) Fotokopje e Diplomës së shkollës së lartë;
- c) Përmbledhje të shkurtër të studimeve dhe analizave të realizuara;
- d) Përmbledhje e shkurtër e materialeve të redaktuara (për kandidatët që do të realizojnë redaktimet).

## Neni 5

### **Regjistrimi i kandidatëve, bashkëpunëtorëve të jashtëm në kuadrin e menaxhimit të “Revistës Letrare/Didaktike”**

1. Mbështetur në këtë rregullore, të drejtën për regjistrim si kandidatë, bashkëpunëtorë të jashtëm në **kuadrin e menaxhimit të “Revistës Letrare/Didaktike”** e gëzojnë të gjithë personat që plotësojnë këto kritere:

1.1 Kërkesa për redaktues shkencorë të Revistës Letrare/Didaktike:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e Revistës Letrare;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin shkencor të dokumentacioneve.

1.2 Kërkesa për gazetarë kulture të Revistës Letrare/Didaktike:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në profilin gjuhë - letërsi;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e Revistës Letrare;
- c) Të kenë përvojë në redaktimin letrar të dokumentacioneve.

1.3 Kërkesa për ilustrues të Revistës Letrare/Didaktike:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë;
- b) Të njohin informacionin, strukturën dhe përmbajtjen e Revistës Letrare/Didaktike;
- c) Të kenë përvojë pune si ilustrues i revistave letrare, kulturore, shkencore;

2. Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

---

- a) CV;
- b) Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë;
- c) Përmbledhje e shkurtër e materialeve të redaktuara;
- d) Përmbledhje e shkurtër e materialeve të faqosura (për kandidatët që do të realizojnë faqosjen).

## **Neni 6**

### **Përzgjedhja e kandidatëve**

1. Njoftimi për shpalljen e nevojës për bashkëpunëtorë të jashtëm publikohet në faqen zyrtare të institucionit.
2. Njoftimi për shpalljen e nevojës për bashkëpunëtorë duhet të përmbajë:
  - a) listën e dokumenteve që duhen paraqitur;
  - b) informacion mbi shërbimin;
  - c) afatin e fundit dhe adresën ku duhet të paraqiten dokumentet.
3. Për kryerjen e procedurave të seleksionimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, Drejtori i QBD-së me urdhër, ngre komisionin përkatës. Komisioni duhet të ketë në përbërje minimalisht 5 anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë nga sektori ku ofrohet shërbimi i fushës përkatëse, që ka lidhje me profilin e kandidatit si bashkëpunëtor. Komisioni vlerëson procedurën e konkurrimit mbi bazën e dosjeve të kandidatëve.
4. Në përfundim të procesit komisioni merr vendim për shpalljen e fituesit.

## **Neni 7**

### **Komisioni**

Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm përbëhet si më poshtë:

- a) Kryetari i Komisionit (Drejtori i Drejtorisë që ka lidhje me sektorin ku ofrohet shërbimi);
- b) Juristi i institucionit; (Harton urdhrat dhe kontratat)
- c) Përgjegjësi i Sektorit ku ofrohet shërbimi;
- d) Specialisti i të njëjtit sektor;
- e) Përgjegjësi i Sektorit të financës.

## **Neni 8**

### **Vlerësimi i kandidatëve**

1. Komisioni shqyrton dosjet e kandidatëve dhe me vendim përcakton fituesit në përputhje me kriteret përkatëse.
2. Komisioni mban procesverbal lidhur me vlerësimin e të përzgjedhurve dhe shpall listën e fituesve.
3. Komisioni i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

## **Neni 9**

## **Ankimimi**

1. Pas shpalljes së listës së fituesve, aplikantët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtën të ankohen me shkrim pranë drejtuesit të QBD-së .
2. Nëse ankesa e aplikuesit gjykohet e drejtë, rivlerësohet përsëri.
3. Vendimi i drejtuesit të QBD-së është përfundimtar.

## **Neni 10**

### **Shpallja e fituesve dhe lidhja e kontratave të përkohshme**

1. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të fituesve, fituesit njoftohen të paraqiten për të lidhur kontratën e shërbimit me QBD-në.
2. Kontratat lidhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 11**

### **Të drejtat dhe detyrat e kandidatëve – bashkëpunëtorë të jashtëm**

1. Bashkëpunëtorët gëzojnë të gjitha të drejtat që u njeh ligji dhe kontratat e lidhura, si dhe kanë për detyrë të zbatojnë me përpikëri të gjitha detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe kontrata.
2. Trajtimi financiar i bashkëpunëtorëve, kryhet sipas VKM-së Nr.120 datë 27.01.1997 *“Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”*, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen me veprimtarinë e këtij institucioni, sipas rasteve të bashkëpunimit.

## **Neni 12**

### **Publikimi**

Të gjitha njoftimet lidhur me procedurat e aplikimit do të gjenden në adresën e internetit të Qendrës së Botimeve për Diasporën [www.qbd.gov.al](http://www.qbd.gov.al).

## **Neni 13**

### **Zbatimi i rregullores**

Personeli i QBD-së dhe bashkëpunëtorët e jashtëm janë të detyruar të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje.

## **Neni 14**

### **Ndryshimi apo shfuqizimi**

1. Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë rregullore bëhen me propozim të sektorëve të QBD-së dhe me miratimin e Drejtorit të QBD-së.
2. Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë rregullore hyjnë në fuqi pas miratimit nga Drejtori i QBD-së.

## **Neni 15**

### **Dispozita e fundit**

Pas miratimit të kësaj rregulloreje nga ana e Drejtorit të QBD së, çdo akt administrativ që rregullon çështjet e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Drejtori i QBD-së.